



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 1966/Prot. 9

Divjakë, më 13.03.2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. 21, DATË 13/03/2025
PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME,
PËR VITIN 2025, NË BASHKINË DIVJAKË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar të VKB Nr.65 datë 24.12.2024, “Për miratimin e PBA 2025-2027, Buxhetit të vitit 2025, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2025”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë,

1. Të miratojë 10 (dhjetë) punonjës mirëmbajtje së rrjetit ujitës dhe faturues uji sezonalë me kontratë të përkohshme, pranë Bashkisë Divjakë, me kontratë 6-mujore, nga periudha 01.04.2025 deri më 30.09.2025 sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij projekt-vendimi.
2. Të miratojë 2 (dy) punonjës sezonalë turni II, (kullat,varkat) me kontratë 4-mujore nga periudha 02.06.2025 deri më 30.09.2025 dhe 3 (tre) punonjës mirëmbajtje dhe pastrimi me kontratë të përkohshme, 3-mujore nga periudha 02.06.2025 deri më 31.08.2025.
3. Të miratojë 6 (gjashtë) punonjës sezonalë në Agjencinë e Shërbimeve Komunale, me kontratë të përkohshme, 3-mujore, nga periudha 02.06.2025 deri më 31.08.2025.
4. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Divjakë për punonjësit sezonalë të Bashkisë Divjakë dhe për punonjësit sezonalë të Agjencisë së Shërbimeve Komunale nga buxheti i Agjencisë së Shërbimeve Komunale. Fondet janë planifikuar në fillim të vitit kalendarik.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve të Brendshme

Eneida Davidhi

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit

Xheladin Brahkola

Spektori Juridik, Prokurimeve Publike dhe
Menaxhimit të Aseteve

Andi Bullari

Agjencia e Shërbimeve Komunale

Çerçis Turhani

KRYETARI

JOSIF GORREA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

N/KRYETARI

ERIS STAMBOLLIU





Lidhja nr. 1

Punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2025 pranë Bashkisë Divjakë, Drejtorisë së Infrastrukturës, Sektori Ujitje-Kullimit dhe Agjencisë së Shërbimeve Komunale.

Nr.	Institucioni	Emërtimi i pozicionit	Nr. i punonjësve	Orari i punës	Kohëzgjatja e kontratës	Paga bruto/lekë
1.	Bashkia Divjakë	Punëtor mirëmbajtje së rrjetit ujitës dhe faturues uji	10	8 orë	01.04.2025-30.09.2025	42 000
2.	Bashkia Divjakë	Sportelist Kulla dhe Varkat, turni II-të	2	8 orë	02.06.2025-30.09.2025	42 000
3.	Bashkia Divjakë	Punonjës mirëmbajtjeje dhe pastrimi	3	8 orë	02.06.2025-31.08.2025	42 000
4.	Agjencia e Shërbimeve Komunale	Punëtor pastrimi	6	8 orë	02.06.2025-31.08.2025	45 000

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
Eneida Davidhi
Drejtorja e Financës dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola
Sektori Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit të Aseteve
Andi Bullari
Agjencia e Shërbimeve Komunale
Çerçis Turhani

KRYETARI
JOSIF GORREA
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETARI
ERIS STAMBOLLIU

